



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-41549/17
Kaçanik, 20.12.2017

Në bazë të nenit 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Komunave –Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 04 Qershor 2008), Udhëzimit Administrativ 2009/01 – të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-Për Procedurat e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 20.12.2017, mori këtë:

V E N D I M PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

I.

1. Me këtë Vendim, Kemal Mërseli nga f. Doganaj i Komunës së Kaçanikut më profesion: Fakulteti Filologji-dega: Gjuhë dhe Letërsi Angleze, anëtarë i Kuvendit të Komunës, zgjidhet: **KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK.**

2. Mandati i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës zgjatë aq sa zgjatë mandati i Kuvendit të Komunës, ndërkaq fillon nga dita e zgjedhjes, 20.12.2017.

3. Detyrat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe në Rregulloren për Punë të Kuvendit të Komunës.

4. Për punën e vet, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i takon kompensimi mujor sipas Udhëzimeve Administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: i Përmenduri, MAPL, Kryetari i Komunës, Udhëheqësi i Administratës dhe Personelit, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 6061-41548 /17
Kaçanik, 20.12.2017

Në zbatim të dispozitave të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të nenit 41 si dhe nenit 2.3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 20.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

1. Me këtë Vendim, formohet komisioni nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në përbërje:

1.1.	Hamid Guri,	nga PDK;
1.2.	Fatijona Kyçyku,	nga LVV; dhe
1.3.	Arlinda Rakoci-Raka,	nga LDK.
2. Detyrë e komisionit si në pikën 1 të këtij Vendimi është, të kujdeset për procedurën e votimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës deri në shpalljen e Rezultatit përfundimtar të votimit.
3. Komisioni më detyrat e caktuara si në Vendim do të filloj menjëherë.
4. Për punën e vet komisioni i përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi do të hartoj Procesverbal, i cili proces do të jetë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
5. Pasi ky komision është Ad Hoc –vetëm për rastin konkret, pas raportimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, pushon së vepruari.



Kryesuesi i mbledhjes
Ekrem Kyçyku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

PROCESVERBAL

I hartuar nga Komisioni i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës, për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Kaçanik.

Zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit janë mbajtur në objektin e komunës, në katin e III-të në sallën e kuvendit, më datë 20 Dhjetor 2017.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Komunës më të drejtë vote është 27 anëtarë.

• Rundi i I - r i votimit:

Në votim kanë marrë pjesë: 27 anëtarë.

1. Vota të vlefshme 26, dhe

2. Vota të pavlefshme 01.

Kandidatët e propozuar, në Rundin e Parë (I-r) të votimit kanë marrë këtë numër të votave;

1. <u>Kemal Myrseli</u>	<u>17</u>	votë,
2. <u>Shpend Krushq</u>	<u>09</u>	votë,
3. _____	_____	votë,
4. <u>02</u>	_____	votë.

• **Rundi i II-të i votimit:**

Në votim kanë marrë pjesë: _____ anëtarë

1. Vota të vlefshme _____, dhe
2. Vota të pavlefshme _____.

Kandidatët e propozuar, në Rundin e Dytë (II-të) të votimit kanë marrë këtë numër të votave:

1. _____ vota dhe
2. _____ vota.

• **Rundi i III-të i votimit:**

Në votim kanë marrë pjesë: _____ anëtarë

1. Vota të vlefshme: _____
2. Vota të pavlefshme : _____.

Kandidatët e propozuar, në Rundin e Tretë (III-të) të votimit kanë marrë këtë numër të votave;

1. _____ vota dhe
2. _____ vota.

REZULTATI PËRFUNDIMTAR

Në bazë të rezultatit të votimit në Rundin e I të votimit, Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve konstaton se kandidati Kemal Merseli, zgjidhet, **KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK.**

Anëtarët e Komisionit, Nënshkrimi

1. Falijona Kysku _____,
2. Artinda Rakoci Raka _____ dhe
3. Herimid Guri _____.